



DIGJITALIZIMI DHE ZHVILLIMI I FINTECH NË SEKTORIN FINANCIAR

Digjitalizimi e ndryshon dukshëm mënyrën në të cilën njerëzit menaxhojnë me financat e tyre, si shpenzojnë njerëzit, si kursejnë, si blejnë dhe si shesin dhe si e zhvillojnë sjelljen e tyre financiare.

Veprimtaria bankare për shembull mund të mundësojë që njerëzit me të ardhura të ulëta të kenë kontroll më të madh dhe më pak stres për paratë e tyre. Por, sipas hulumtimeve digjitalizimi mund të paraqesë rrezik për konsumatorët, veçanërisht për gratë dhe të rriturit që nuk kanë shkathtësi digjitale esenciale të nevojshme për jetën e përditshme.

Mungesa e shkathtësive digjitale mund të çojë edhe në dëme më të mëdha financiare (për shembull mashtrime, borxhe problematike përmes kredisë dhe bixhozit online), andaj ndërtimi i shkathtësive për siguri është me rëndësi esenciale.



E - MAPAS
nr. 42

gusht 2022



Na ndiqni në:

[http://www.facebook.com/
MAPAS.MK](http://www.facebook.com/MAPAS.MK)

Rreth 90% të kompanive dhe institucionet në MKD janë të vetëdijshëm për përfitimet që i sjell digjitalizimi i shërbimeve financiare”

“Mbi 70% e kompanive investojnë në transformimin digjital. Fintek sektori gjithnjë e më shumë zgjerohet në industrinë e pagesave, e cila po kërkon mënyra të reja për të ulur shpenzimet, për përvojë më të mirë të klientëve.”



Financat digjitale mund të paraqesin mënyrë për përfshirje më të madhe në ekonominë formale përmes qasjes dhe shfrytëzimit të transaksioneve financiare formale, në vend të pagesave me para në dorë.


UEB FAQJA E RE E MAPAS – MË SHUMË SHËRBIME DIGJITALE PËR PËRDORUESIT



<https://mapas.mk/>



1. Kontroll online i të sigurvearit në cilin fond të detyrueshëm pensional është anëtar.



<https://mapas.mk/proverka-i-raspredelba-na-osigurenik/>

2. Qasja e shpejtë në informatat për numrin e anëtarëve dhe për vlerën e mjeteve neto të fondeve pensionale në “kohë reale”


3. Qasja e shpejtë në të dhënat për agjentët e shoqërisë pensionale



<https://mapas.mk/agenti/kontaktiraj-agent-na-penzisko-drushtvo/>


Për ditë më të sigurta të pensionistit

4. Mundësia për parashtrim elektronik të deklarates me shkrim për vazhdim të anëtarësisë në fondin e detyrueshëm pensional për të siguruarin që ka mbushur stazhin e sigurimit me kohëzgjatje të shtuar që mundëson zvogëlim të kufirit të pleqërisë për realizim të të drejtës së pensionit të pleqërisë për së paku një vit.



<https://mapas.mk/benificiran-stazh/>

5. Porta për novacione që u mundëson Fintek kompanive për të realizuar komunikim me MAPAS me qëllim zhvillimin e novacioneve në sferën e sigurimit pensional me financim kapital.



6. Mundësia për vlerësim online dhe paraqitje të parregullsive në punën e MAPAS nga ana e përdoruesve.




<https://mapas.mk/prijavi-nepravilnost-do-mapas/>

RISI

MJETET TOTALE TË FONDEVE TË DETYRUESHME PENSIONALE NË VITIN 2021 TEJKALUAN 100 MILIARDË DE- NARË

Gjatë vitit 2021, mjetet e përgjithshme të fondeve të detyrueshme pensionale tejkalluan 100 miliardë denarë dhe në fund të vitit 2021 arritën në 105,66 miliardë denarë, përkatësisht u rritën për 21% në krahasim me vitin 2020. Ndërsa gjithsej mjetet e fondeve pensionale vullnetare shënuan rritje më të madhe në raport me gjithsej mjetet e fondeve të detyrueshme pensionale, përkatësisht u rritën për 25% dhe arritën në 2,9 miliardë denarë. Me këtë totali i mjeteve të fondeve pensionale në shtyllën e dytë dhe të tretë arritën rreth 15% të prodhimit bruto vendor për vitin 2021. Kjo vërehet në Raportin për gjendjet në sigurimin pensional me financim kapital në vitin 2021, të cilin e përgatiti Agjencia për Mbikëqyrjen e Financimit Kapital të Sigurimit Pensional - MAPAS.



https://mapas.mk/wp-content/uploads/2022/06/izvestaj-kfpo_2021_web.pdf

AKTIVITETE PËR MBROJTJEN DHE PËRMIRËSIMIN E MJEDISIT JETËSOR

Në kuadër të aktiviteteve për mbrojtje dhe përmirësim të mjedisit jetësor dhe me qëllim rritjen e vetëdijes te qytetarët, të punësuarit nga MAPAS e pastruan lokacionin Proevce – Kumanovë. Aktiviteti u realizua në rrethinë të burimit të ujit mineral natyror. Me këtë vërtetohet se MAPAS vazhdon me aktivitete që zhvillohen së paku dy herë në vit, me qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor



MAPAS LËSHOI LEJE PËR THEMELIMIN E SHO- QËRISË SË KATËRT PENSIONALE

Agjencia për Mbikëqyrjen e Financimit Kapital të Sigurimit Pensional – MAPAS më datë 31.05.2022 lëshoi leje numër 04 për themelimin e shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale vullnetare të Shoqërisë për menaxhim me fondet e hapura dhe të mbyllura investuese VFP FOND MENAXHMENT SHA SHKUP

Keni pyetje dhe ankese?

Lajmërohuni në MAPAS ose shkruani mesazh në contact@mapas.mk



AGJENCIA E SUPERVIZIONIT TË SIGURIMIT PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL (MAPAS)

Stiv Naumov 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut,
tel: (02) 3224 229
<https://mapas.mk>